

VENDIM Nr. 1270

Për

Ndryshimin e Rregullores Nr. 16 për Shërbimet Radio Amator në Republikës së Kosovës

Në mbështetje të Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikime Elektronike, neni 10, paragrafi 4), neni 54, paragrafët 2.6), neni 56 dhe neni 79 paragrafi 1) dhe 2) (tutje referuar si - Ligji) dhe neni 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të (Ref. Nr.Prot.054/B/17) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (tutje referuar si ARKEP ose Autoriteti), Bordi Drejtues i Autoritetit në përbërje prej:

- 1) z. Kreshnik Gashi Kryetar
- 2) z. Nijazi Ademaj Anëtar
- 3) z. Hazir Hajdari Anëtar
- 4) z. Bahri Anadolli Anëtar dhe
- 5) z. Shqiprim Pula Anëtar

në mbledhjen e 32-të me radhë të mbajtur me datë 02 Nëntor 2018, pas shqyrtimit të rekomandimit të Departamenti për Menagjimin e Frekuencave për ndryshimin e tarifave për shërbimet radio amatore, unanimisht morri këtë:

V E N D I M

- I. Ndryshohet neni 11 paragrafi 1) i Rregullorja Nr. 16 për Shërbimet Radio Amatore si në vijim:
 - Të gjithë parashtruesit e formularit të kërkesës për autorizim radio amatore duhet të paguajnë shumën prej 10.00 € (dhjetë) euro në emër të tarifës administrative për procesim.
- II. Ndryshohet neni 11 paragrafi 5) i Rregullorja Nr. 16 për Shërbimet Radio Amatore si në vijim:
 - Radio amatorët e huaj që kërkojnë të pajisen me autorizim radio amator me shenjë thirrëse speciale Z68, duhet të paguajnë shumën prej 50.00 € (pesëdhjetë) euro në emër të shenjes speciale dhe tarifës administrative për procesim.

III. Të gjitha dispozitat tjera mbetën në fuqi sikurse në Rregulloren Nr. 16 për Shërbimet Radio Amatore në Republikën e Kosovës.

IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Ligji, respektivisht neni 10, paragrafët 4) i Ligjit përcakton që Autoriteti: *“Miraton legjislacionin sekondar lidhur me këtë ligj, të cilat janë në kompetencë të Autoritetit, mbështetur në dispozitat e këtij ligji.”*

Neni 54 paragrafi 2.6 i Ligjit përcakton që Autoriteti përcakton kushtet për pagesat për mbikëqyrje të shfrytëzimit të radio-frekuencave (kanaleve), si dhe pagesat tjera në buxhetin e shtetit në përputhje me procedurat e vendosura në akte juridike;

Neni 56 i Ligjit përcakton që *“Procedura për dhënien e të drejtës për aktivitete radio amatore dhe çfarëdo aktiviteti tjetër për shfrytëzim të radio stacioneve, si dhe kushtet dhe procedurat për dhënie të autorizimeve për aktivitete të tilla duhet të vendosen nga Autoriteti.”*

Andaj, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

Prishtinë, 23/11/2018

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Kreshnik Gashi
Kryetar i Bordit



Aktvendimi i dërgohet:

- Shoqata e Radio Amatorve /SHRAK
- DMF
- Departamenti ligjor, ARKEP,
- Arkivit, ARKEP